



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 39, datë 21.04.2020

**“PËR
MIRATIMIN E FAMILJEVE APLIKUESE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I
BLLOK-NDIHMËS EKONOMIKE DERI NË 6 PËRQIND, NGA FONDI I
KUSHTËZUAR DHE NGA BUXHETI I BASHKISË TIRANË, PËR PERIUdhËN 1-31
MARS 2020”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 24, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, Kreut IV, pikat 2, 3 dhe 6, të vendimit nr. 597, datë 04.09.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, vendimit nr. 157, datë 26.12.2019, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2020”, të ndryshuar, vendimit nr. 3, datë 05.02.2020, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e kriterëve, procedurave, dokumentacionit dhe sistemit të pikëzimit, për përdorimin e fondit të kushtëzuar ose fondit të buxhetit vendor, mbi programin e bllok-ndihmës ekonomike deri në 6 përqind per vitin 2020”, si dhe referuar Raportit Përmbledhës nr.12611 prot., datë 15.04.2020, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Miratimin e listës së familjeve përfituese nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6 përqind nga buxheti i Bashkisë Tiranë, për periudhën 1-31 Mars 2020, sipas tabelës nr.1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Miratimin e listës së familjeve përfituese nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6 përqind nga fondi i kushtëzuar për periudhën 1-31 Mars 2020, sipas tabelës nr. 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Efektet financiare sipas pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi, do të mbulohen nga fondi i vënë në dispozicion nga fondi i kushtëzuar dhe buxheti vendor për programin e bllok-ndihmës ekonomike deri në 6 përqind.
4. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale dhe Njësitë Administrative të Bashkisë Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

KRYETAR

TONI GOZU




Tabela nr. 1

Përmbledhëse e njesive administrative për përdorimin e fondit nga programi i bllok -ndihmes ekonomike me buxhetin vendor Mars 2020

Nr.	Njesia Administrative	Masa e ndihmës ekonomike	
		Nr. Familjeve	Lekë
1	Njesia 1	16	37.260
2	Njesia 2	18	37.940
3	Njesia 3	1	3.060
4	Njesia 4	11	24.720
5	Njesia 5	11	27.540
6	Njesia 6	15	40.100
7	Njesia 7	12	29.860
8	Njesia 8	9	21.760
9	Njesia 9	23	58.000
10	Njesia 10	5	9.000
11	Njesia 11	10	30.660
12	Njesia Petrele	0	0
13	Njesia Farke	0	0
14	Njasia Dajt	0	0
15	Njesia Zall-bastar	2	5.700
16	Njesia Berzhite	5	11.060
17	Njesia Krrabe	6	15.660
18	Njesia Baldushk	5	23.980
19	Njesia Shengjergj	3	6.300
20	Njesia Vaqarr	6	16.000
21	Njesia Kashar	5	14.220
22	Njesia Peze	1	8.000
23	Njesia Ndroq	8	29.220
24	Njesia Zall-herr	2	11.000
	TOTALI	174	461.040

Punoi: Olgena Haderllari



Tabela nr.2

Përmbledhëse e njësive administrative për përdorimin e fondit të kushtëzuar deri në 6% për muajin Mars 2020

Nr.	Njesia Administrative	Masa e ndihmës ekonomike	
		Nr. Familjeve	Lekë
1	Njesia 1	0	0
2	Njesia 2	7	16.380
3	Njesia 3	4	10.800
4	Njesia 4	10	25.100
5	Njesia 5	4	7.200
6	Njesia 6	14	36.420
7	Njesia 7	9	23.300
8	Njesia 8	9	23.280
9	Njesia 9	10	28.320
10	Njesia 10	5	10.800
11	Njesia 11	14	29.700
12	Njesia Petrele	0	0
13	Njesia Farke	0	0
14	Njesia Dajt	6	18.180
15	Njesia Zall-bastar	9	21.420
16	Njesia Berzhite	0	0
17	Njesia Krrabe	0	0
18	Njesia Baldushk	0	0
19	Njesia Shengjergj	4	9.720
20	Njesia Vaqarr	5	13.560
21	Njesia Kashar	13	33.840
22	Njesia Peze	0	0
23	Njesia Ndroq	6	14.460
24	Njesia Zall-herr	0	0
	TOTALI	129	322.480

Punoi: Olga Haderllari

